



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:243885
Datë: 07.02.2024
Numri i dokumentit: 05293847

AA.nr.224/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Delushe Halimi dhe Valon Totaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.F, komuna e Podujevës, kundër të paditurës së parë Agjencia e Regjistrimit Civil dhe të paditurës së dytë Komuna e Prishtinës, me bazë juridike anulim i vendimit të të paditurës së parë Agjencia e Regjistrimit Civil Nr.10/2023 të datës 27.02.2023 si dhe të paditurës së dytë Komuna e Prishtinës, vendimi me numër 201-118475 i datës 30.03.2021, duke vendosur lidhur me ankesat e palës së paditur të parë dhe palës së paditur të dytë të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2581/2021, të datës 08.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesa e të paditurës së parë Agjencia e Regjistrimit Civil, dhe ankesa e të paditurës së dytë Komuna e Prishtinës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2581/2021, i datës 08.03.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2581/2021, të datës 08.03.2023, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, është aprovuar në tersi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit N.F, komuna e Podujevës dhe ANULOHET vendimi i të paditurës së parë Agjencia e Regjistrimit Civil Nr.10/2023 i datës 27.02.2023 si dhe vendimi i të paditurës së dytë Komuna e Prishtinës me numër 201-118475 i datës 30.03.2021. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura e dytë Komuna e Prishtinës që paditësin ta regjistroj në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile me këto të dhëna personale: N.F, data e lindjes..., komuna e Podujevës nga babai I.F dhe e ëma H.F, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Kurse nën pikën III të dispozitivit është vendos qe ky aktgjykim e zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Në pikën IV të dispozitivit është vendos qe secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur e paditura e parë Agjencia e Regjistrimit Civil, përmes përfaqësueses së saj, Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet në tersi si e bazuar ankesa e të paditurës së parë Agjencia e Regjistrimit Civil dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar A. Nr. 258/2021 i datës 08.03.2023 si dhe të refuzohet në tersi si e pabazuar padia e paditësit

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur edhe e paditura e dytë Komuna e Prishtinës - Avokatura Publike e Komunës, për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet në tersi ankesa si e bazuar kurse aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të priset dhe lënda ti kthehet të njëjtës në rigjykim, apo ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj në tersi si të pa bazuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, avokat Hasan Rexha nga Prishtina, ka parashtruar përgjigje në ankesën e të paditurës Komuna e Prishtinës, duke propozuar që e njëjtat të refuzohet si e bazuara dhe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesa, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi kundër të paditurës së parë Agjencia e Regjistrimit Civil dhe të paditurës së dytë Komuna e Prishtinës, për anulim të vendimit të të paditurës së parë Agjencia e Regjistrimit Civil Nr.10/2023 të datës 27.02.2023 si dhe vendimit të të paditurës së dytë Komuna e Prishtinës, me numër 201-118475 të datës 30.03.2021.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, të paraqitur kundër vendimeve të paditurës së parë Agjencia e Regjistrimit Civil Nr.10/2023 të datës 27.02.2023 si dhe të paditurës së dytë Komuna e Prishtinës, me numër 201-118475 të datës 30.03.2021, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke i anuluar vendimet e lartcekura. Me arsyetim në lidhje me këtë çështje juridike, gjykata e shkallës së parë kishte vendosur me Aktgjykimin A.nr.2581/2021 të datës 01.11.2021 me të cilin kishte aprovuar padinë e paditësit si të bazuar dhe kishte detyruar të paditurën e parë që në afat prej 30 ditësh të nxjerrë vendim sipas kërkesës së përsëritur të paditësit të datës 12.10.2021 dhe vendimin t'ia dorëzoj palës sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura e parë, përkatësisht Avokatura Shtetërore, Aktgjykimin e sipërpërmendur e kishte pranuar në mënyrë të rregullt me datë 21.12.2022, mirëpo e njëjta duke e shpërfillura Aktgjykimin e kësaj Gjykate dhe kërkesat e udhëzimet konkrete të përcaktuara në Aktgjykimin fillestar, nuk kishte marrë vendim brenda afatit 30 ditor të përcaktuar nga gjykata në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi. Tutje, pala paditëse me parashtresën e datës 14.02.2023 e njofton Gjykatën e shkallës së parë se e paditura e parë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim edhe pas kërkesës së përsëritur nga ana e përfaqësuesit të paditësit në lidhje me obligimin e të paditurës së parë për të nxjerrë vendim sipas kërkesës së Gjykatës së shkallës së parë. Më tutje, gjykata e shkallës së parë me datë 15.02.2023 mbi bazë të nenit 68, paragrafit 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, kishte kërkuar nga e paditura të njoftohet mbi shkaqet për të cilat nuk

është nxjerrë akti administrativ. Në lidhje me këtë kërkesë të Gjykatës së shkallës së parë, e paditura nuk kishte përfillur Kërkesën e Gjykatës duke mos dhënë asnjë njoftim dhe duke mos marrë asnjë vendim brenda afatit ligjor. Në anën tjetër, pala paditëse me parashtrësën e datës 07.03.2023 e ka njoftuar Gjykatën e shkallës së parë se nuk është përfillur asnjë rekomandim i Gjykatës në vendimin e me pastajme të marrë nga e paditura, duke i propozuar Gjykatës së shkallës së parë që të vendos vet për këtë çështje juridike.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi kishte ushtruar ankesë tek e paditura e parë me datë 03.08.2021, kundër vendimit Nr.01-201-118475 të datës 30.06.2021 të lëshuar nga Drejtoria e Administratës/Shërbimi i Gjendjes Civile, me seli në Prishtinë. Meqenëse e paditura e parë nuk kishte nxjerrë asnjë vendim në lidhje me ankesën e paditësit, i njëjti, në përputhje të plotë me ligjin, të paditurës së parë me datë 12.10.2021 i kishte dërguar Kërkesën e përsëritur për vendosjes sipas ankesës fillestare. Gjykata e shkallës së parë gjeti se në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e paditura e parë nuk kishte nxjerrë vendim ashtu siç kishte qenë e obliguar nga ana e Ligjit, prandaj e njëjta kishte rënë në heshtje administrative. Gjykata e shkallës së parë nga shkresat e lëndës si dhe nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, e veçanërisht nga deklaratimet verbale të përfaqësuesit të paditësit dhe përfaqësueses të të paditurës së dytë Komuna e Prishtinës, gjeti se në rastin konkret kemi të bëjmë me një procedurë administrative të zhvilluar kryesisht me pasaktësi, kryesisht nga të paditurat. Këtë e dëshmon edhe faktin se me përgjigjen në padi të të paditurës së dytë, e tërë rrjedha e procedurës administrative nuk ishte sqaruar në masën e duhur, e që pastaj të kishte mundësi të vendosej sipas kërkesës së palës paditëse. Argument për këtë, po ashtu është edhe deklarata e përfaqësueses së të paditurës së dytë, e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor, se nuk ka ndonjë kundërshtim specifik sa i përket padisë së paditësit dhe se këto fakte duhen të zbardhen dhe duhet të merret një vendim i cili do ta ndihmonte procesin e eliminimit të pengesave administrative për regjistrimin e një personit që tanimë është i gjallë. Gjykata e shkallës së parë gjeti se përgjigjja në padi e të paditurit të parë, nuk është dhënë në frymën e Aktvendimit A.nr.2581/2021 të datës 23.08.2022. Nga përgjigjja në padi e të paditurës së parë, gjykata e shkallës së parë gjeti se e njëjta i referohet vendimit të Komisionit të organit të shkallës së dytë, përderisa nga shkresat e lëndës, rezulton se nuk kemi fare vendim të organit të shkallës së dytë, por me institutin e heshtjes administrative. Nga kjo, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se e paditura e parë, në këtë konflikt administrativ, nuk ka demonstruar të ketë njohuri të saktë në lidhje me çështjen juridike e cila u trajtua në këtë konflikt administrativ. Nga e tërë ajo që u tha më lartë, gjykata e shkallës së parë po ashtu konstatoi se e paditura e parë nuk ka vepruar në përputhje me nenin 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për të shqyrtuar ankesën e paditësit dhe kërkesën e përsëritur të tij dhe për të marrë në konsideratë duke shqyrtuar të gjitha provat e paraqitura nga pala paditëse.

Nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se e paditura e parë ka shkelur udhëzimet e Gjykatës me të cilat në Aktgjykimin paraprak kishte udhëzuar të paditurin e parë që të zbatoj në tërësi nenin 95 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të thërras dhe të dëgjoj palën paditëse, ngase dëgjimi i palës paditëse në këtë çështje juridike, është jashtëzakonisht i rëndësishëm për sqarimin e të gjitha rrethanave. Në këtë drejtim, organi i paditur ishte obliguar që në bazë të shkresave të lëndës dhe pohimeve të paditësit apo përfaqësuesit të tij, të marrë informacionet e bollshme, përmes së cilave do të dëshmohej se në rastin konkret kemi të bëjmë me një person tjetër emri i së cilit ishte N.F i cili kishte lindur me datë ... dhe i cili kishte vdekur me datë..., gjë të cilën organi i paditur nuk e ka bërë. Në anën tjetër, kemi të bëjmë me paditësin i cili është i lindur më datë..., komuna e Podujevës, nga i ati L... dhe e ëma H... Pra, ishte e domosdoshme që pas dëgjimit të palës paditëse, i padituri i parë të arrij të bëj dallimin në mes të këtyre fakteve, qartësimi i së cilave ishte lehtësisht i mundshëm. Nga shqyrtimi dhe analizimi i aktit administrativ përfundimtar të nxjerrë pas kalimit të afatit ligjor të përcaktuar nga Gjykata e shkallës së parë, përkatësisht të vendimit Nr.10/2023, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me nenin 47, 48 dhe 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Vendimi i të paditurës, objekt shqyrtimi në këtë konflikt administrativ, në mungesë të elementeve të detyrueshme të aktit

administrativ është marrë me shkelje të nenit 47 të LPPA-së. Organi i paditur ka shkelur nenin 47, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.1 të LPPA-së, duke mos dhënë asnjë shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe asnjë referencë të vetme në Ligjin në fuqi për Procedurën e Përgjithshme Administrative. E paditura e parë, poashtu ka dështuar të arsyetoj aktin administrativ si në vështrim të nenit nenin 48 të LPPA-së.

Gjykata e shkallës së parë po ashtu ka gjetur se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga e paditura e parë, e që nga kjo ka rezultuar edhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Vendimi i të paditurës së parë shfaq kontradiktorialitet të theksuar tek pjesa e arsyetimit. Kështu, përdërisa në njërën anë, i bëhet referencë rekomandimit të Inspektoratit të ARC-së të datës 22.06.2021 dhe thuhet se Zyra e gjendjes civile ka rishqyrtuar rastin dhe ka ardhur në përfundim se regjistrimi i vdekjes në RTHV nuk ka qenë i bazuar në gjendjen faktike, në anën tjetër, e paditura e parë konstaton se komuna ka qenë e detyruar sipas detyrës zyrtare të bëjë anulimin e regjistrimit të vdekjes për N.F. Në lidhje me këtë gjykata e shkallës së parë ka gjetur se e paditura e parë, përkatësisht Komuna e Prishtinës, përkatësisht Zyra përkatëse e Gjendjes Civile, është dashur të marrë në konsideratë të gjitha gjetjet e Inspektoratit të ARC-së të ardhura si rezultat i inspektimit të tyre, mirëpo megjithatë, rekomandimi i Inspektoratit të ARC-së, për nga natyra nuk paraqet akt administrativ detyruar për organin e inspektuar, por vetëm pikëpamje të të njëjtit mbi inspektimin e kryer. Në një gjendje të tillë vendimi nga ana e organit të shkallës së parë është dashur të merret me bindje të lirë e pavarësi të plotë për të vendosur dhe vërtetuar drejtë dhe saktë gjendjen faktike, duke analizuar të dhënat e palës paditëse, dokumentacionin përkatës me të cilin kishte disponuar pala paditëse dhe duke e krahasuar me regjistrat përkatës. Gjykata e shkallës së parë konstatoi se e paditura e dytë nuk ka arritur që të zbatoj nenin 11, paragrafin 2 të LPPA-së i cili përcakton se: *“Organi publik, gjatë procedurës administrative, ndihmon që palët të mbrojnë dhe realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike, sa më lehtë të jetë e mundur por pa cenuar të drejtat dhe interesat juridik të personave të tjerë”*. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se e paditura e parë nuk ka arritur të zbatoj në mënyrën e duhur nenin 51 të Ligjit për Gjendjen Civile. Njëjtë ka vepruar edhe organi i shkallës së dytë, për faktin që të njëjtit nuk kanë arritur të arsyetojnë procedurën e pavlefshmërisë, për faktin që e njëjta nuk i përgjigjet realitetit dhe faktit që paditësi është gjallë, posedon një mori me dokumente sipas të dhënave me të cilët kërkon regjistrimin dhe se marrja e vendimit mbi bazë të nenit 51 të Ligjit për Gjendjen Civile, është e kundërligjshme, me mungesë absolute të kompetencës së këtij organi administrativ për të zhvilluar procedura të tilla. Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në këtë çështje administrative-juridike në çdo fazë të procedurës administrative të zhvilluara në të dy organet, është shkelur ligji në dëm të paditësit, dhe organet e paditura kanë dështuar të marrin Vendime të drejta e të bazuara në Ligj në lidhje me ankesën e paditësit, duke mos zbatuar dhe duke mos përfillur Aktgjykimin e kësaj Gjykate të dhënë paraprakisht në këtë çështje të konfliktit administrativ.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se padia e paditësit është e bazuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës së parë dhe të paditurës së dytë, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në

drejtëshmërin dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës së parë dhe të dytë në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancat dhe seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës së parë dhe të dytë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se komisioni duke vepruar sipas pikëpamjeve të aktgjykimit A.Nr.258/2021 të datës 21.12.2022 ka shqyrtuar kërkesën e përsëritur dhe të gjitha provat e lëndës dhe nga kjo rezulton se regjistrimi i mëvonshëm i vdekjes nr. RTHV nga Komuna e Prishtinës ishte bërë me kërkesë të nënës të N.F, ku sektori i gjendjes civile kishte nxjerr vendimin me nr. 01-203/186368 të datës 18.08.2015 duke administruar provat që i kishte paraqitur parashtruesi i kërkesës e që në mungese të provave të tjera për ZGJC- Prishtinë ka qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pas inspektimit të rastit nga inspektor të ARC-së zyra e gjendjes civile ka shqyrtuar rastin dhe ka ardh në përfundim se regjistrimi i vdekjes në RTHV nuk ka qenë i bazuar në gjendjen faktike, si e gjetur nga inspektorati ku theksohet se regjistrimi i parë i N.F me datëlindje... në Prishtinë është bërë me procedurë të rregullt ligjore mbi bazën e flete lëshimit të spitalit me nr. 3522-6667. Prandaj për këtë arsye komuna e Prishtinës ka qenë e detyruar sipas detyrës zyrtare të bëjë anulimin e regjistrimit të vdekjes për N.F. Këto pretendime ankimore, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi ngase vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin që të njëjtat nuk kanë arritur të arsyetojnë procedurën e pavlefshmërisë, për faktin që e njëjta nuk i përgjigjet realitetit dhe faktit që paditësi është gjallë, posedon një mori me dokumente sipas të dhënave me të cilët kërkon regjistrimin. Andaj, në këtë drejtim kolegji i kësaj gjykate konsideron se pretendimet ankimore të përfaqësuesve të autorizuar, të paditurës së parë dhe të dytë, janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadsisë. Në këtë kontest në arsyetimin e aktgjykimit, janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Andaj, pranë një gjendje të tillë faktike, kolegji i kësaj gjykate konsideron se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji i kësaj gjykate ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të paditurës së parë dhe të dytë, se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kur e ka aprovuar kërkesën e paditësit, mirëpo këto pretendime ankimore, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke pasur parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesat e përfaqësuesve të autorizuar, të paditurës së parë dhe të dytë, u refuzuan si të pa bazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Numri i lëndës: 2021:243885
Datë: 07.02.2024
Numri i dokumentit: 05293847

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.224/2023, me datë 05.02.2024

Kryetari i kolegjit,

Ramiz Kuqi